




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË



V E N D I M

Nr. 10, datë 12.10. 2011

P Ë R
“KRIJIMIN E AGJENCISË SË MBROJTJES SË KONSUMATORIT
PRANË BASHKISË SË TIRANËS ”

Në mbështetje të nenit 8 pika 1, shkronja “ç”, neni 32 shkronja “ç” e ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”; nenit 128 e ligjit nr.8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Proçedurave Administrative” (i ndryshuar); ligjit nr.9902, datë 17.04.2008 për “Mbrojtjen e konsumatorëve”, (i ndryshuar); ligjit nr.9803, datë 04.11.2004 për “Shërbimin dhe inspektoratinveterinar”, ligjin nr. 9010, datë 13.02.2003 për “Administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta”; vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 798, date 29.09. 2010 për “Miratimin e rregullores për administrimin e mbetjeve spitalore”; udhëzimit të Ministrit të Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjitikës nr. 721, datë 27.10. 2010 për “Kriteret e organizimit dhe drejtimit të qendrave të këshillimit të konsumatorëve” neni 37 të ligjit 9936, datë 26.06.2008 për “Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; neni 6, shkronja “a” dhe “b” të ligjit nr.10405, datë 24.3.2011 për “Kompetencat për caktimin e pagave të punës” (i ndryshuar); vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1619, datë 02.07.2008 për “Klasifikimin e funksioneve dhe grupimin e njësisve të qeverisjes vendore, për efekt page, dhe për caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore” (i ndryshuar); vendimit të Këshillit të Ministrave nr.566, datë 14.07.2010 për “Përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”; me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, VKB-së nr.78, datë 27.12.2007 mbi “Miratimin e strukturës organizative të aparatit të Bashkisë së Tiranës” (i ndryshuar), me propozim të kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,



V E N D O S I:

1. Të miratojë krijimin e Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit, si institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës.
2. Të miratojë strukturën organizative të Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit me një numër prej 93 (nëndëdhjetë e tre) punonjësish, sipas organigramës në Aneksin nr.1, bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Të miratojë nivelin e pagës për punonjësit e Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit, sipas lidhjes nr. 13 bashkëlidhur këtij vendimi.

4. Të reflektohet transferimi i strukturave përkatëse prej strukturës organizative të Bashkisë së Tiranës në strukturën e Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit.
5. Efektet financiare për vitin 2011, të shkaktuara nga ndryshimet sipas pikës 4, të përballohen nga fondi i pagave të aparatit të Bashkisë.
6. Në mbështetje të pikës 1 të këtij vendimi, të hartohet rregullorja e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit, e cila do të paraqitet për miratim në Këshillin Bashkiak të Tiranës.
7. Për zbatimin e këtij vendim, ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Planifikimit Strategjik, Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun, Drejtoria e Kontrollit të Territorit Urban dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore.
8. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

KRYETARI

Niazi KOSOVRASTI



REPUBLICA E SHQIPËRISE
BASHKIA E TIRANES
DEPARTAMENTI I MBROJTJES SE KONSUMATORIT

